VENDIM
Nr. 40, datë 6.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 7.4.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 2 Akti që i përket:

KËRKUES: Fatmir (Gazmir) Zeneli

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 118, datë 19.7.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 148, datë 26.9.2000, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 26, datë 17.1.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 33, 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, Fatmir Zeneli, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është hetuar në mungesë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila në përfundim të hetimeve ka dërguar për gjykim çështjen penale me akuzën e kryerjes së veprave penale “Vrasje me paramendim për motive të dobëta” të shtetasit L.H., “Vrasje me dashje” të shtetasit A.C., “Vrasje e mbetur në tentativë” në dëm të shtetasit D.P.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 118, datë 19.7.2000, ka vendosur *inter alia* deklarimin fajtor të kërkuesit, Fatmir (Gazmir) Zeneli, për kryerjen e veprave penale “Vrasje me paramendim”, të shtetasit L.H., “Vrasje me dashje”, të shtetasit A.C., “Plagosje të rëndë”, të shtetasit D.P., dhe “Armëmbajtje pa leje”, duke e dënuar atë përkatësisht në bazë të nenit 78/1 të Kodit Penal (KP-së) me 25 vjet burgim, në bazë të nenit 76 të KP-së me 20 vjet burgim, në bazë të nenit 88/1 të KP-së me 10 vjet burgim dhe në bazë të nenit 278/2 të KP-së me 2 vjet burgim. Përfundimisht, në bazë të nenit 55 të KP-së e ka dënuar kërkuesin me 25 vjet burgim.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 148, datë 26.9.2000, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 118, datë 19.7.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për sa i përket vrasjes së shtetasit L.H., duke e deklaruar kërkuesin Fatmir Zeneli fajtor për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim dhe në bazë të nenit 78/2 të KP-së e ka dënuar atë me burgim të përjetshëm. Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për sa i përket vrasjes së shtetasit A.C., plagosjes së shtetasit D.P. dhe armëmbajtjes pa leje. Përfundimisht,

kërkuesi në bazë të nenit 55 të KP-së është dënuar me burgim të përjetshëm.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 26, datë 17.1.2001, mbi bazën e rekursit të bërë nga përfaqësuesi i kërkuesit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pasi ai nuk përmbante shkaqe si ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penal (KPP).

5. Kërkuesi në të tria shkallët e gjykimit është gjykuar në mungesë dhe interesat e tij në gjykim i ka mbrojtur avokati i caktuar nga familjarët e tij. Në datën 17.8.2015, ai është ekstraduar nga shteti grek dhe u është dorëzuar autoriteteve shqiptare mbi bazën e një urdhri ekzekutimi për dënimin e dhënë për të dhe ka filluar vuajtjen e dënimit.

II

6. ***Kërkuesi, Fatmir Zeneli*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

6.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka cenuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit si dhe të drejtën për t`u mbrojtur dhe për t`u dëgjuar, pasi kërkuesi nuk ka marrë dijeni efektive për procesin penal në ngarkim të tij. Nga ana e gjykatës nuk është bërë asnjë njoftim formal për thirrjen e tij, duke mos përmbushur detyrimet që burojnë nga KPP-ja.

6.2 Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka kryer njoftimet për kërkuesin (në cilësinë e të pandehurit), si dhe e ka zhvilluar gjykimin pa deklaruar mungesën e tij. Gjithashtu, kjo gjykatë ka administruar në gjykim ankimin e bërë nga familjarët e tij në kundërshtim me ligjin procedural.

6.3 Gjykimi në apel është zhvilluar në prani të avokatit XH.P., pa u verifikuar më parë tagrat e përfaqësimit të tij dhe vlefshmëria e aktit të përfaqësimit që gjendej në dosje.

6.4 Në dhënien e vendimit Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka përmendur akuzat e reja të përdorura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nuk është shprehur pse ka rënduar pozitën e të pandehurit pavarësisht mospërdorimit në akuzë të neneve të shtuara.

6.5 Gjykata e Lartë është investuar për rekursin e paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët në kundërshtim me nenin 410 të KPP-së, duke ezauruar kështu të drejtën e kërkuesit për ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

6.6 Edhe pse në rekursin e paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur prej familjarëve të kërkuesit janë paraqitur të gjitha shkeljet e kryera nga gjykatat më të ulëta, vendimi i mospranimit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, por pa arsyetuar vendimin e saj.

7. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, ka kundërshtuar pretendimet e kërkuesit në këto drejtime:

7.1 Kërkuesi nuk ka shteruar më parë mjetet e nevojshme të ankimit të parashikuara nga KPP-ja, ligji nr. 8322, datë 2.4.1998, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Ekstradimin dhe të dy protokolleve shtesë...", si dhe ligji nr. 10193, datë 3.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", neni 51 i tij.

7.2 Pretendimi i kërkuesit në lidhje me mungesën e arsyetimit të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit, është i pabazuar, pasi ky vendim është i arsyetuar.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

8. Gjykata paraprakisht vlerëson të analizojë prapësimin e subjektit të interesuar për moslegjitimimin e kërkuesit pasi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Sipas Prokurorisë së Përgjithshme kërkuesi, si i gjykuar në mungesë, mund të paraqesë kërkesë përpara juridiksionit kushtetues vetëm pasi të ketë përfunduar procesi gjyqësor i rivendosjes në afat të së drejtës së

ankimit.

9. Në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, individi mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Rregulli i vendosur nga dispozita e mësipërme kushtetuese e detyron kërkuesin që për zgjidhjen e çështjes së tij t'iu drejtohet të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Kërkuesi legjitimohet vetëm kur shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nën-kupton se ai duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka theksuar se neni 131/f i Kushtetutës ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar prej saj, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi të ketë shteruar mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimet nr. 15, datë 18.4.2007, nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Çështja e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion nga i gjykuari në mungesë është trajtuar gjerësisht edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ-ja), e cila mban qëndrimin se Konventa u lë shteteve kontraktuese diskrecion të gjerë në lidhje me zgjedhjen e mjetit të parashikuar për të garantuar se sistemet e tyre ligjore janë në përputhje me dispozitat e nenit 6. Në veçanti, mjetet procedurale, të ofruara nga e drejta dhe praktika e brendshme, duhet të tregojnë se janë efektive kur një person i akuzuar për një vepër penale nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur e për t'u mbrojtur vetë dhe nuk ka kërkuar t'i shmanget gjykimit (*shih Sejdovic kundër Italisë, [DHM], nr. 56581/00, § 83, 1 mars 2006*). Ndonëse GJEDNJ-ja nuk përcakton shprehimisht mjetin procedural efektiv për rivendosjen e të drejtave të pretenduara si të cenuara, në jurisprudencën e saj mbizotëron qëndrimi se detyrimi i ankuesve është pikërisht shterimi i mjeteve të brendshme ligjore, të cilat janë të vlefshme në teori dhe praktikë, në periudhën përkatëse, të aksesueshme, që mund të sigurojnë ndreqjen e ankimeve të tyre dhe që ofrojnë perspektiva të arsyeshme suksesi (*shih Sejdovic kundër Italisë, § 46*). Për më tepër, vlerësimi nëse janë shteruar mjetet e brendshme ligjore, normalisht bëhet duke iu referuar datës në të cilën është depozituar ankimi në gjykatë. Megjithëse ky rregull përbën një përjashtim, i cili mund të justifikohet nga rrethanat specifike sipas rastit (*shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. GJEDNJ-ja ka theksuar se në rast se gjenden disa mjete ligjore, të cilave mund t'u referohet aplikanti, ai është i lirë të zgjedhë mjetin që trajton ankimin e tij/e saj (*shih Croke kundër Irlandës, nr. 33267/96, 15 qershor 1999*). Me fjalë të tjera, kur mjeti ligjor është zgjedhur, nuk kërkohet përdorimi i një mjeti tjetër që në esencë ka të njëjtin qëllim (*shih Moreira Barbosa kundër Portugalisë, nr. 65681/01, 2004–V*). Ajo ka theksuar gjithashtu se ankimi para Gjykatës Kushtetuese është një mjet ligjor efektiv për të kundërshtuar një dënim në mungesë (*shih Shkalla kundër Shqipërisë, §§ 59-62, 10 gusht 2011*).

13. Bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese, në rastet e gjykimit në mungesë në të gjitha shkallët e gjykimit mjeti efektiv në dispozicion të kërkuesit është paraqitja e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi që do të verifikojë nëse autoritetet kanë respektuar rregullat procedurale dhe kanë marrë të gjitha masat ligjore për njoftimin e rregullt të kërkuesit për procesin gjyqësor të filluar ndaj tij. Në raste të tilla kërkuesit nuk i kërkohet shterimi i mjeteve të tjera ligjore, siç është kërkesa për rishikim në Gjykatën e Lartë apo paraqitja e kërkesës për rivendosjen në afat. Në kushtet kur proceset gjyqësore në ngarkim të kërkuesit janë përfunduar në të tria shkallët e gjykimit, paraqitja e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është mjeti efektiv që ofron mundësitë e arsyeshme për rivendosjen e të drejtave të pretenduara, duke kundërshtuar dënimin in absentia (*shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura në kërkesë *prima facie* janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, Gjykata, bazuar në aktet e administruara në dosjen e çështjes, vëren se kërkuesi është njohur me vendimin penal nr. 148, datë 26.9.2000, të Gjykatës së Apelit Vlorë përmes njoftimit të datës 17.8.2015, kur është ekzekutuar urdhri i datës 14.11.2000 i prokurorit pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Rrjedhimisht, duke qenë se data e fillimit të afatit dy vjeçar, brenda të cilit kërkuesi mund të paraqesë një ankim kushtetues, është 17.8.2015 dhe kërkesa në Gjykatën Kushtetuese mban datën 20.10.2015, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

15. Në përfundim, Gjykata vlerëson se prapë-simi i subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, në lidhje me mungesën e legjitimimit të kërkuesit të gjykuar në mungesë, është i pabazuar.

B. Për pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit

16. Kërkuesi pretendon se nuk ka marrë dijeni efektive për procesin penal në ngarkim të tij si rezultat i mospërmbushjes nga ana e autoriteteve të detyrimeve që burojnë nga KPP-ja për njoftimin e të pandehurit që nuk gjendet. Nga ana e gjykatës nuk është bërë asnjë njoftim formal për thirrjen e tij, duke mos përmbushur detyrimet që burojnë nga KPP-ja. Për rrjedhojë, ai pretendon se i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar, e drejta për t'u mbrojtur, parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

17. Gjykata ka konsoliduar qëndrimin se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë, që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. E drejta e një personi të akuzuar për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtat-shme për seancën, si dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij. Po ashtu, një nga kriteret e gjykimit të drejtë është edhe e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, e drejtë e cila nuk humbet edhe pse personi i akuzuar penalisht nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*shih vendimin nr. 26, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushte-tuese*).

18. Në rastin e gjykimit në mungesë është detyrë e autoriteteve publike që të informojnë të pandehurin nëse ka ose jo një procedim penal në ngarkim të tij, pasi vetëm kështu mund të arrihet siguria se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Në këtë mënyrë duhet që autoritetet shtetërore të marrin të gjitha masat e nevojshme për të informuar të pandehurin dhe vetëm nëse janë të sigurt se ai ka marrë njoftim në formën që parashikon ligji, atëherë mund të vazhdohet me procedimin në mungesë. Ndaj është rigoroz zbatimi i proce-durave të njoftimit (*shih vendimin nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve (*shih vendimin nr. 10, datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çdo rast, synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi (*shih vendimin nr. 23, datë 23.7.2009 të Gjykatës Kushte-tuese*).

20. Caktimi i mbrojtësit në procesin penal në kushtet dhe mënyrat e parashikuara në ligj, përfshirë dhe atë të caktuar kryesisht nga gjykata, nuk ka për qëllim vetëm pjesëmarrjen e tij në një shkallë të gjykimit, por ndjekjen e çështjes nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së ankimit dhe

pjesëmarrjes në të, deri në instancën më të lartë gjyqësore, për të mbrojtur plotësisht të drejtat e të pandehurit në një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata ka vlerësuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Gjithashtu, Gjykata në praktikë të vazhdueshme nuk ka pranuar pretendimet e individit për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në garantimin e këtyre standardeve (*shih vendimet nr. 49, datë 29.9.2014, nr. 40, datë 22.9.2011, nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Kërkuesi ka pretenduar se gjykimi në mungesë është realizuar në prani të një avokati të zgjedhur nga familjarët e tij, i cili nuk përfaqëson vullnetin e tij, në kundërshtim me rregullat procedurale. Për më tepër, kërkuesi ka preten-duar se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë, përfaqësuesi i tij ka qenë pa tagra përfaqësimi.

23. Gjykata, bazuar në materialet e adminis-truara në dosjen gjyqësore, vëren se për kërkuesin ka dy vendime për mosgjetjen e tij, një të prokurorit të çështjes dhe një të oficerit të Policisë Gjyqësore ku shprehet se "i akuzuari është larguar në drejtim të paditur, ai është kërkuar në banesën e tij dhe se nga të dhënat operative rezulton se është larguar [...]". Pas kësaj njoftimi i materialeve të çështjes, njoftimi i akuzës dhe i dërgimit të çështjes në gjyq i janë komunikuar Dhomës së Avokatisë, duke iu referuar avokatit të caktuar kryesisht. Gjithashtu, edhe për zhvillimin e seancave gjyqësore me të akuzuar kërkuesin, njoftimet i janë dërguar Dhomës së Avokatisë, duke iu referuar avokatit të caktuar kryesisht. Me aktmarrëveshjen e datës 30.7.1998 rezulton se kunati i kërkuesit ka kërkuar që interesat e tij në të gjitha shkallët e gjykimit të përfaqësohen nga avokat Xh.P., i cili ka vijuar me përfaqësimin e kërkuesit në procesin gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Më pas të gjitha njoftimet për seancat gjyqësore i janë drejtuar këtij avokati. Gjithashtu, nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se është po ky avokat, i cili pas dhënies së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe ka paraqitur edhe rekurs në Gjykatën e Lartë.

24. Nenet 140/1, 141 dhe 142 të KPP-së përcaktojnë rregullat për njoftimin e të pande-hurit dhe organet kompetente, me qëllim siguri-min e një procesi të rregullt ligjor për të pande-hurin. Nga rrethanat e parashtruara më lart, Gjykata vëren se nga faktet e shqyrtuara nuk konstatohet shkelje e kërkesave të ligjit proce-dural për njoftimin e të pandehurit. Në fillim është marrë vendimi për mosgjetjen e kërkuesit dhe më pas i është caktuar avokati kryesisht, ku këtij të fundit i janë njoftuar materialet e dosjes dhe akuza për kërkuesin. Pas kësaj nga ana e familjarëve, me anë të një aktmarrëveshjeje, është caktuar një avokat tjetër, i cili është autorizuar për të përfaqësuar kërkuesin në të gjitha shkallët e gjykimit. Nga materialet e dosjes gjyqësore vërehet se në ankimin e bërë në Gjykatën e Apelit Vlorë, si edhe në rekursin e bërë në Gjykatën e Lartë, është ngritur vetëm pretendimi për cilësim të ndryshëm të veprës penale dhe nuk është ngritur asnjë pretendim i cili ka të bëjë me aspekte të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, siç pretendon kërkuesi në kërkesën e tij.

25. Në tërësinë e tij procesi gjyqësor i zhvilluar ndaj kërkuesit në aspektin kushtetues ka qenë i rregullt, pasi interesat e tij në të tria shkallët e gjykimit janë përfaqësuar nga mbrojtësi i tij, i caktuar sipas dispozitave procedurale në fuqi.

26. Nga rrethanat e faktit, si dhe nga veprimet e kërkuesit pas kryerjes së veprës penale, Gjykata arrin në konkluzionin se autoritetet kanë respektuar procedurat në lidhje me njoftimin dhe për pasojë kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal të zhvilluar në ngarkim të tij, por është larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur, gjithashtu, me vullnet të lirë, të mos marrë pjesë në gjykimin e çështjes, me qëllim për t'iu fshehur drejtësisë.

27. Duke pasur parasysh se neni 33 i Kushtetutës sanksionon se nuk mund të përfitojë nga e

drejta kushtetuese për t'u dëgjuar nga gjykata personi që i fshihet drejtësisë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të gjykimit në mungesë, është i pabazuar.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

28. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, është i pa arsyetuar.

29. Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimit gjyqësor si një detyrim i sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës dhe një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngush-tësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe në funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimin nr. 12, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në gjetjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Argumentet e dhëna në vendim duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimin nr. 23, datë 20.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Edhe GJEDNJ-ja, duke iu referuar procesit të drejtë, të garantuar nga neni 6 i KEDNJ-së, ka theksuar se kjo dispozitë i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument. Detyrimi për të arsyetuar vendimin, varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih Marini kundër Shqipërisë,18 dhjetor 2007, § 105; Van de Hurk kundër Holandës, 19 prill 1994, § 61*).

32. Sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standar-deve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimin nr. 77, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se vendimet gjyqësore i kanë respektuar standardet si më sipër. Vendimet gjyqësore nuk rezultojnë të jenë alogjike, të kenë kundërthënie apo të mos kenë pasqyruar në mënyrë të mjaftueshme argumentet në mbështetje të përfundimit të shprehur në dispozitiv. Po ashtu, edhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë e ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimit objekt shqyrtimi. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs i ka dhënë përgjigje kërkuesit lidhur me to, në rastin konkret, se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Në kushtet kur nuk ka pretendime të natyrës kushtetuese, vetëm fakti i shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se procesi gjyqësor nuk ka qenë i rregullt nga pikëpamja kushtetuese.

34. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfun-dimin se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur, cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit si rezultat

i mosnjoftimit efektiv të tij nga autorite-tet përgjegjëse, si dhe cenimin e parimit të arsye-timit të vendimit gjyqësor, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari